



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës  
Agencija za Upravljanje Memorijalnih Kompleksa Kosova  
Agency for the Management of Memorial Complexes of Kosovo

**Komuna e Kamenicës**  
Opstina Kamenic / Kamenica Municipality



**MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËFINANCIM**

PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “Bunkeri i Gjon Sereqit” në Shipashnicë  
KOMUNA E KAMENICËS

Palët Nënshkruese:

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK) – përfaqësuar nga  
Drejtori Bislim Zogaj

dhe

Komunës së Kamenicës – përfaqësuar nga Kadri Rahimaj – Kryetari i Komunës

## **Neni 1 Qëllimi**

Kjo marrëveshje bashkëpunimi për bashkëfinancim lidhet në mes të AMKMK-së, përfaqësuar nga Drejtori Bislëm Zogaj dhe Komunës së Kamenicës, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës Kadri Rahimaj, me qëllim të financimit të projektit të përbashkët me titull: “Bunkeri i Gjon Sereqit” në Shipashnicë - Komuna e Kamenicës.

## **Neni 2 Mënyra e bashkëfinancimit të projektit**

Projekti për “Bunkeri i Gjon Sereqit” në Shipashnicë - Komuna e Kamenicës ka vlerën prej 20,000.00 €.

**2.1.** AMKMK financon këtë projekt në vlerën prej 16,000.00€ nga kodi 18687 të parapara sipas planit buxhetor të Agjencisë për vitin 2022.

**2.2.** Komuna e Kamenicës financon pjesën tjetër të projektit në shumën prej 4,000.00€ mjete që do të ndahen nga buxheti i vitit 2023.

## **Neni 3 Obligimet e AMKMK-së**

3.1. AMKMK obligohet që për projektin “Bunkeri i Gjon Sereqit” në Shipashnicë - Komuna e Kamenicës të zhvillojë procedurat e prokurimit për procesin e tenderimit, vlerësimit dhe dhënies së kontratës.

3.2. AMKMK emëron Menaxherin/Organin mbikëqyrës për realizimin e projektit si dhe për inspektimin e punimeve deri në përfundimin e projektit.

3.3. AMKMK është e obliguar ta njoftojë Komunën për rrjedhat e realizimit të projektit.

## **Neni 4 Obligimet e Komunës**

4.1. Komuna e Kamenicës zotën mjetet për projektin nga neni 2 i kësaj marrëveshjeje dhe një kopje të zotimit e sjell në AMKMK për realizimin e kontratës sipas marrëveshjes.

4.2. Paguesa për financimin e projektit “Bunkeri i Gjon Sereqit” në Shipashnicë - Komuna e Kamenicës do të bëhet në pajtim me realizimin e projektit, sipas situacionit dhe raportit të Organit Mbikëqyrës dhe Menaxherit të Projektit.

4.3. Komuna mund të caktojë një zyrtar vëzhgues për përcjelljen e zbatimit të projektit “Bunkeri i Gjon Sereqit” në Shipashnicë - Komuna e Kamenicës i cili do të raportojë Komunës.

4.4. Pas përfundimit të projektit, ky investim do të regjistrohet në SIMFK si aset i AMKMK-së

**Neni 5**  
**Kohëzgjatja e marrëveshjes**

Marrëveshja e lidhur ndërmjet AMKMK-së dhe Komunës së Kamenicës përfundon me përfundimin e projektit.

**Neni 6**  
**Ndryshime dhe ndërprerja e kontratës**

6.1. Të gjitha palët zotohen se do ti përmbahen kësaj marrëveshjeje bashkëfinancimi dhe se në raste kontesti eventual apo paqartësi në tekstin e kësaj marrëveshjeje, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim, në të kundërtën kompetent për zgjidhjen e kontestit do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje Ekonomike.

6.2. Me pëlqim të Drejtorit të AKMKM-së dhe Kryetarit të Komunës kjo marrëveshje mund të ndryshohet dhe të plotësohet.

**Neni 7**


Kjo marrëveshje partneriteti është përpiluar në 4 (katër) ekzemplarë identik, ku nga një marrin palët, kurse të tjerat mbesin për nevojat e organit kompetent.

**Neni 8**  
**Hyrja në Fuqi**

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo marrëveshje e mirëkuptimit fillon të zbatohet nga data e nënshkrimit të saj.

**PALËT NË MARRËVESHJE**

**Agjencia për Menaxhimin e**  
**Komplekseve Memoriale të Kosovës**

  
**Bislim Zogaj**  
**Drejtor i AMKMK**



**Komuna e Kamenicës**

  
**Kadri Rahimaj**  
**Kryetari i Komunës**



Datë: 06/09/2022  
Prishtinë